



Jaya Kundër
KORRUPSIONIT
9-14 DHJETOR 2018



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË KOSOVË



POZITA 1

POZITA 2

POZITA 3

POZITA 4

POZITA 5

POZITA 6

POZITA 7

#IKD #GLPS #ÇOHU #INPO
#GAP #COLUMBUS #KIPRED #ACDC

Prishtinë, dhjetor 2018

Autorët: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)
 Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)
 Instituti për Studime të Avancuara (GAP)
 Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet (ÇOHU)
 Instituti Kosvar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED)
 Inciativa për Progres (INPO)
 Instituti Columbus

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e autorëve.

“Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jomedoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit”.

Dizajn: Anymate

Përmbajtja

I.	Hyrje.....	4
II.	Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.....	5
III.	Pushteti legjislativ:	10
1)	Kuvendi i Kosovës dhe institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvend	10
IV.	Pushteti Ekzekutiv	15
1)	Zyra e Kryeministrit, Ministritë dhe Agjencitë e ekzekutivit.....	16
2)	MAPL dhe Komunat	28
V.	Pushteti gjyqësor dhe prokurorial.....	31

I. Hyrje

Kuvendi i Kosovës në pajtim me obligimet e marra lidhur me plotësimin e kriterëve që dalin nga Agjenda e Reformës Evropiane kishte miratuar Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, i cili ligj, më 20 prill 2018, ishte dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Ligji është publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës më 27 prill 2018, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, respektivisht më 12 maj 2018.

Koalicioni Java kundër Korrupsion 2018, nga analiza dhe hulumtimi i afërsisht 4000 zyrtarëve të lartë publik, ka identifikuar në praktikë 563 zyrtarë të lartë publik që ushtrojnë apo kanë të hyra nga së paku dy burime që paguhen nga buxheti i Kosovës, 63 zyrtarë të lartë publikë që pranojnë të hyra nga burime që paguhen nga buxheti i Kosovës, 10 zyrtarë publikë që pranojnë të ardhura nga katër burime nga buxheti i Kosovës dhe 19 zyrtarë të lartë publikë që pranojnë të ardhura nga pesë burime që paguhen nga buxheti i Kosovës.

Në përgjithësi janë analizuar të dhënat për 656 zyrtarë publik. Nga kjo shifër 581 zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë në institucione publike, 60 zyrtarë kanë nga dy pozita, 10 zyrtarë kanë nga tri pozita si dhe 5 zyrtarë kanë nga katër pozita.

Në vazhdim janë shtjelluar të gjitha aspektet e qëllimit të Ligjit të ri për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik si dhe gjendjen në të gjitha institucionet publike, në të është hulumtuar sesa zyrtarët e lartë mbajnë shumë pozita.

II. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Kuvendi i Kosovës në pajtim me obligimet e marra lidhur me plotësimin e kriterëve që dalin nga Agjenda e Reformës Evropiane kishte miratuar Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, i cili ligj, më 20 prill 2018, ishte dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Ligji është publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës më 27 prill 2018, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, respektivisht më 12 maj 2018.

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2016 për Kosovën, kishte kërkuar që gjatë vitit 2017, Kosova duhet në veçanti të ndryshojë kuadrin ligjor mbi konfliktin e interesave, duke përshtatur atë me standardet evropiane.

Në nëntor të vitit 2016, Kosova dhe Bashkimi Evropian (BE) përmes dialogut të nivelit të lartë ishin pajtuar lidhur me prioritet kyçe të Agjendës për Reforma Evropiane (ARE), në realizimin e veprimeve prioritare nga ana e institucioneve në Kosovë, me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim në drejtim të avancimit të Kosovës në rrugën e saj evropiane. Kosova në kuadër të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ARE, në kuadër të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, kishte marr për obligim ndryshimin e ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloreve përkatëse, duke i sjellë ato në përputhshmëri me standardet evropiane dhe të përcaktimit të rrethanave të sakta kur zyrtarët publik mund të angazhohen në punë shtesë dhe të emërohen.¹

Sipas kërkesës së ARE, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike do të duhej të ndryshohej në harmoni me rekomandimet e BE-së, duke përfshirë fushat e më poshtme:

- a) Përcaktimi qartë i kategorive të zyrtarëve publik;
- b) Theksimi në mënyrë të qartë i aktiviteteve që zyrtarëve iu lejohej dhe ndalohej t'i kryejnë përderisa mbajnë postin;
- c) Theksimi në mënyrë të qartë i aktiviteteve që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit;
- d) Theksimi i qartë i obligimeve të zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit; dhe
- e) Procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.²

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve. Ligji ka përcaktuar parimin se zyrtari publik duhet ta kryejë punën e

¹ “Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë – BE për Prioritetet Kyçe – Agjenda për Reforma Evropiane (ARE)” – Nëntor, 2016, faqe 5. (Shih linkun https://www.mei-ks.net/repository/docs/era_final_sq.PDF)

² “Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë – BE për Prioritetet Kyçe – Agjenda për Reforma Evropiane (ARE)” – Nëntor, 2016, faqe 10. (Shih linkun https://www.mei-ks.net/repository/docs/era_final_sq.PDF)

tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të forcojë besimin e qytetarëve në institucione.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, si sponzorizues i këtij ligji, përmes një statusi në Facebook, kishte falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik. Sipas ministrit Tahiri, miratimi i këtij ligji është hap i rëndësishëm në parandalimin e konfliktit të interesit, meqenëse krijohet bazë e mirëfilltë ligjore që lufton format e ndryshme të abuzimit me pushtetin.

“Që nga fillimi i mandatit kam qenë i përkushtuar për të adresuar fuqizimin e sundimit të ligjit dhe për të siguruar legjislacion që parandalon dhe lufton korrupsionin si dhe rritë integritetin e institucioneve publike. Kjo mendësi është shprehur edhe në projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik. Përmbajtja e këtij projektligji reflekton një bazë të mirëfilltë ligjore që lufton format e ndryshme të abuzimit me pushtetin dhe pozitën institucionale, që kufizon veprimet dhe interesat private të zyrtarëve publik gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe që bën të mundur shmangien e konfliktit të interesit përmes fokusit në parandalim”.³

Koalicioni Java kundër Korrupsion 2018 konsideron se qëllimi i këtij ligji në vete ngërdhen standarde dhe parime që për qëllim kanë qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Duke marr për bazë standardet ndërkombëtare në kuptim të integritetit të zyrtarit publik në ushtrimin e funksionit publik, duhet marr për bazë vlerat që përcaktojnë qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit sikurse janë ndërshmëria dhe drejtësia. Në këtë drejtim zyrtarët publik gjatë ushtrimit të funksionit publik gjatë gjithë kohës duhet të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të ndershme dhe në mënyrë të drejtë. Ushtrimi i funksioneve në mënyrë të ndershme dhe të drejtë në vete ngërthen edhe besimin e publikut apo edhe përceptimin e publikut nëse zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit përçon besim, siguri dhe paanshmëri.

IKD së bashku me AKK kanë filluar një fushatë mediatike për risitë e këtij ligji, duke përgatitur spot me pikat kyçe, të cilat institucionet dhe zyrtarët që ushtrojnë funksione publike të informohen për të pasur një zbatim të tyre në praktikë. Ndërkaq, prej shtatorit 2018, IKD ka avokuar tek Ministria e Drejtësisë si sponsorizuese dhe AKK si autoritet qendror në zbatimin e këtij ligji që të ketë interpretim të disa dispozitave të këtij ligji, zbatimi i të cilave afekton drejtpërdrejtë buxhetin e Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Ministri Tahiri, ka krijuar një Grup Punues në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Shoqërisë Civile, por që ende nuk është finalizuar dokumenti i grupit. Për trajtimin e temës së konfliktit të interesit në kuadër të “Javës Kundër Korrupsionit 2018” janë informuar të gjithë akterët institucional, përfshi Ministrinë e Drejtësisë dhe AKK-në. Ndikimi i “Javës Kundër Korrupsionit 2018” ka sjellë në konferencë për shtyp akterët institucional, të cilët pas gjashtë muajve të hyrjes në fuqi të

³ Abelard Tahiri, Ministër i Drejtësisë, 25 janar 2018.

Ligjit Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, kanë informuar publikun për hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe masat e ndërmarra për zbatimin e tij në praktikë.

Më 19 nëntor 2018, Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli ishte takuar në një takim me Ministrin e Drejtësisë Abelard Tahiri, Ministrin e Financave, Bedri Hamza dhe Drejtorin e Agjencisë kundër Korrupsion, Shaip Havolli. Në këtë takim është diskutuar lidhur me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, dhe zbatimit të tij në praktikë.

Kryetari i Kuvendit Kadri Veseli në konferencë për media lidhur me zbatimin e këtij ligji kishte deklaruar se ajo që jemi duke e bërë është që shteti ligjor të jetë përmbi të gjithë ne e përgëzoj ministrin e drejtësisë për parandalimin e konfliktit me këtë ligj, për aq sa janë një mori ligjesh të cilat drejtpërdrejtë lidhen me pjesën e forcimit të ligjit në Kosovë, kam për qëllim të dërgoj një mesazh tek qytetarët e vendit tonë që ne, institucionet e Republikës së Kosovës, jemi duke e bërë maksimumin e përpjekjeve tona që të minimizohet hapësira e keqpërdorimeve dhe abuzimeve me pozitën e zyrtarit të lartë apo zyrtarit publik, për vetë faktin se ne gjithë paguhemi nga taksat e qytetarëve të vendit tonë. Mesazhi është ky: ligji është më i fortë se secili prej nesh, Republika e Kosovës shteti ynë i pavarur dhe sovran është prioriteti i yni dhe ne nuk do të tolerojmë askënd që të abuzojë me një pozicion të cilin mund ta ketë publik, në të njëjtën kohë për të gjitha ata që kanë mundur apo mund të kryejnë veprime të cilat janë abuzive kundër ligjit, do të kenë përgjegjësinë e tyre para ligjit deri edhe në konfiskimin e pasurisë.”⁴

Pjesë tjetër e rëndësishme për të siguruar qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit, është garantimi i kryerjës së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente. Praktikrat ndërkombëtare kanë ndërtuar standardin se ushtrimi i funksioneve publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente ka për qëllim promovimin dhe ruajtjen e integritetit personal të zyrtarit dhe të institucionit që përfaqëson. Komponentë e rëndësishme e këtij parimi është efikasiteti dhe profesionalizmi në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi.

Në këtë drejtim edhe kufizimet e përcaktuara në nenin 12 dhe 13 të këtij ligji duhet të evitojnë në praktikë rastet e ushtrimit të funksioneve publike në kundërshtim me frymën e ligjit dhe neneve të lartëpërmendura përmes të cilave do të cenohej parimi i efikasitetit, profesionalizimit, integriteti personal i zyrtarit publik dhe institucionit që përfaqëson, kredibiliteti dhe evitimi i situatave që mund të ulin besimin e publikut në zyrtarin publik apo institucionin që përfaqëson.

Ministri Abelard Tahiri në konferencën për media më 19 nëntor 2018, kishte deklaruar “se marrin një hap tepër të rëndësishëm me qëllim zbatimin më efikas të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Tashmë Republika e Kosovës ka në fuqi një politikë të re për parandalimin e konfliktit të interesit. Ka në fuqi një politikë të re e cila realisht parandalon keqpërdorimin e shumave të konsiderueshme të taksapaguesve tanë. Po ashtu ka një politikë të re e cila po ashtu parandalon keqpërdorimin e pozitave nga zyrtarë të ndryshëm në kuadër

⁴ Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Kosovës, në konferencë për media me 19 nëntor 2018.

të institucioneve të Republikës së Kosovës. Pra ky ligj që tash është në fuqi prek mbi 80.000 shërbyes civil në kuadër të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe tashmë pra është tejet e rëndësishme që në prag të vendimmarrjes për liberalizim të vizave po ashtu ka qenë kërkesë e Bashkimit Evropian një politikë e tillë e cila është në fuqi dhe ne e kemi miratuar në Kuvendit e Republikës së Kosovës. Padyshim që në cilësinë e ministrit të drejtësisë tani e tutje do të vazhdoj me një angazhim të përbashkët së bashku me drejtorin e agjencisë, që të ju bëjë me dije edhe ndërmarrjeve publike, edhe universiteteve publike në Republikën e Kosovës, edhe institucioneve, për politikën e cila është në fuqi dhe për atë që duhet të parandalojmë, në të kundërtën normalisht të gjithë këta zyrtarë duhet të ballafaqohen me ligjin në rast se keqpërdorimeve dhe abuzimeve me me paratë publike.”

Perceptimi dhe besimi i publikut në zyrtarët publike dhe institucionet publike cenohet rëndë në ato raste kur zyrtarë publik gjatë orarit të punës, në të njejtën kohë ushtrojnë dy, tre, katër apo pesë e më shumë funksione në të njejtën kohë, dhe kur për këtë pranon kompenzim qoftë përmes pagave shtesë apo të hyra tjera.

Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsion, kishte deklaruar në konferencën e 19 nëntorit 2018, se Kosova ka një ligj mjaft të avancuar. “Kanë qenë rekomandimet nga vetë institucionet Kosovare, Agjencia, dhe poashtu ka qenë rekomandim edhe i Zyrës së BE-së që ky ligj të plotësohet, të ndryshohet dhe të avansohet. Siq e dini shumë pozita deri më tash, zyrtarët e lartë kanë mbajtur shumë pozita nëpër institucione të ndryshme, tash e tutje ky ligj i ri i shkurton këto pozicione dhe kanë të drejtë vetëm në një pozitë zyrtarët e lartë që të jenë pjesë e një organi drejtues. Po ashtu, ne jemi duke punuar që ti fuqizojmë edhe brenda institucionet mekanizmat e brendshëm, brenda institucionit që ta trajtojmë çështjen e konfliktit të interesit.”

Koalicioni Java kundër Korrupsion 2018 me qëllim të adresimit të këtij fenomeni ka analizuar dhe hulumtuar zbatimin në praktikë të këtij ligji nga ana zyryatëve publik nga ana e tre pushteteve në Kosovë, pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv dhe pushteti gjyqësor.

Koalicioni Java kundër Korrupsion 2018, më qëllim të një analize dhe hulumtimi më gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e këtij ligji në praktikë, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publikë dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kishte paraqitur kërkesa për qasje në informatat si në vijim:

- a) Listat e pagave të zyrtarëve publik,
- b) Të dhënat ku përfshiheshin pagat, kompenzimet, medijtjet, shtesat dhe çdo shpenzim tjetër në kuptim të shpërblimit më pagesë të zyrtarit publik, nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Kërkesat për qasje në dokumente publike lidhur me qasjen e të dhënave të lartëpërmendura iu ishin drejtuar pothuajse të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë Kuvendin e Kosovës dhe agjencive dhe institucionet që raportojnë para Kuvendit të Kosovës.

Kërkesa iu ishte drejtuar edhe Qeverisë së Kosovës, përfshirë Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, të gjitha ministrive, komunave dhe agjencive që raportojnë pranë Qeverisë së Kosovës. Kërkesë e njejtë ishte drejtuar edhe sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë, përfshirë Akademisë së Drejtësisë.

Lidhur me kërkesat e lartë-përmendura, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me 19 tetor 2018, në përgjigjen drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, kishte konfirmuar se qasja në informatat e kërkuara nga Koalicioni Java kundër Korrupsion është e ligjshme dhe se Ministria e Drejtësisë, në funksionit të transparencës të ofroj të dhënat e kërkuara duke anonimizuar vetëm të dhënat personale të personave public, ku përfshihet anonimizimi i numrit personal, bankës, datëlindja etj.

Koalicioni Java kundër Korrupsion 2018, gjatë hulumtimit dhe analizës ligjore, dhe ndikimit në praktikë, ka identifikuar dy fusha kryesore që mund të krijojnë rrethana dhe situata të konfliktit të interesit nëse institucionet respektive nuk ndërmarrin masa për të parandaluar dhe luftuar situatat e konfliktit të interesit, rastet kur zyrtarët e lartë publikë ushtrojnë më shumë se një pozitë në sektorin publik dhe rastet kur zyrtarët e lartë publik pranojnë kompensim në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik përfundimisht ka adresuar çështjen e “supermenëve” në institucionet publike, të cilët në të njëjtën kohë mbajnë disa pozita drejtuese. Praktika e “supermenëve” ndalohet në mënyrë eksplicite në nenin 13, paragrafin 2 të këtij ligji, i cili përcakton se: “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj.”

Neni 13 i këtij Ligji, papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik përcakton edhe situatat kur zyrtarit publik i ndalohet të ushtroj më shumë se një pozitë në organe apo institucione drejtuese. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”⁵

Koalicioni Java kundër Korrupsion 2018, nga analiza dhe hulumtimi i afërsisht 4000 zyrtarëve të lartë publik, ka identifikuar në praktikë 563 zyrtarë të lartë publik që ushtrojnë apo kanë të hyra nga së paku dy burime që paguhen nga buxheti i Kosovës, 63 zyrtarë të lartë publikë që pranojnë të hyra nga burime që paguhen nga buxheti i Kosovës, 10 zyrtarë publikë që pranojnë të ardhura nga katër burime nga buxheti i Kosovës dhe 19 zyrtarë të lartë publikë që pranojnë të ardhura nga pesë burime që paguhen nga buxheti i Kosovës.

⁵ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat e zyrtarëve të lartë publikë që ushtrojnë më shumë se një pozitë në të trija pushtetet, institucionet dhe agjencionet që e zbatojnë ligjin në Republikën e Kosovës.

III. Pushteti legjislativ:

Në hulumtimin dhe analizimin e të dhënave për zyrtarët e lartë publik që e deklarojnë pasurinë në pushtetin legjislativ është angazhuar organizata Çohu. Në përgjithësi janë analizuar të dhënat për 656 zyrtarë publik. Nga kjo shifër 581 zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë në institucione publike, 60 zyrtarë kanë nga dy pozita, 10 zyrtarë kanë nga tri pozita si dhe 5 zyrtarë kanë nga katër pozita.

1) Kuvendi i Kosovës dhe institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvend

Në mënyrë që të monitorohet zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (LIGJI Nr. 06/L -011), Organizata Çohu ka hulumtuar të hyrat e zyrtarëve publik të cilët kanë obligim të deklarojnë pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit e që mbajnë pozita në Kuvendin e Kosovës dhe në të gjitha institucionet e pavarura të cilat raportojnë në Kuvend. Përveç regjistrave të pasurisë Çohu dorëzuar kërkesa për qasje në pagesat bazë dhe shtesë për secilin zyrtar publik në këto institucione në mënyrë që të analizojë burimin e të hyrave për periudhën prill-shtator 2018, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Gjithsej Çohu ka dorëzuar kërkesa në 34 institucione publike prej të cilave ka pranuar përgjigje nga 12 institucione. Pavarësisht kësaj shumica e përgjigjeve kanë qenë gjysmake sepse kanë përfshirë vetëm pagën bazë e jo pagesat shtesë apo mëditjet. Në këtë mënyrë analiza e Organizatës Çohu është bazuar në të dhënat nga Agjencia Kundër Korrupsionit në mënyrë që të kemi të dhëna sa më korrekte lidhur me të hyrat e zyrtarëve publik.

Organizata Çohu ka analizuar deklaratimet e pasurisë së vitit 2017 për këto institucione:

- Kuvendi i Kosovës
- Agjencia Kosovare e Privatizimit
- Agjencia Kosovare e Pronës
- Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Agjencia e Intelegjencës së Kosovës
- Agjencia kundër Korrupsionit
- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare:
- Autoriteti i Aviacionit Civil:

- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës:
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave:
- Institucioni i Avokatit të Popullit:
- Banka Qendrore e Kosovës:
- Zyra Kombëtare e Auditimit:
- Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina:
- Zyra e Rregullatorit për Energji:
- Radio Televizioni i Kosovës:
- Organi Shqyrtues i Prokurimit:
- Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut:
- Komisioni Rregullativ i Prokurorimit Publik:
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale:
- Komisioni i Pavarur i Mediave:
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës:
- Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturor:
- Gjykata Kushtetuese:
- Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës:

Në përgjithësi janë analizuar të dhënat për 656 zyrtarë publik. Nga kjo shifër 581 zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë në institucione publike, 60 zyrtarë kanë nga dy pozita, 10 zyrtarë kanë nga tri pozita si dhe 5 zyrtarë kanë nga katër pozita.

Kuvendi i Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 154 zyrtarë që deklarojnë pasurinë, të cilët mbajnë pozita në Kuvendin e Kosovës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 127 e kanë nga një pozitë publike, 20 zyrtarë kanë nga dy pozita ndërsa 7 zyrtarë kanë nga tri pozita.

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 41 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 37 e kanë nga një pozitë publike, 3 zyrtarë kanë dy pozita ndërsa 1 zyrtarë ka tri pozita.

Agjencia Kosovare e Pronës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 14 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë Kosovare të Pronës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 12 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë dy pozita.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 5 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Nga

analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 4 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 1 zyrtar ka dy pozita.

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 7 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 5 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 3 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Agjencia e Intelegjencës së Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 3 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë e Intelegjencës së Kosovës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Agjencia kundër Korrupsionit

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 5 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 3 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 13 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Autoritetin Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Autoriteti i Aviacionit Civil

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 13 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Autoritetin e Aviacionit Civil. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 8 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 11 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 9 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Institucioni i Avokatit të Popullit

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 19 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Institucionin e Avokatit të Popullit. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Banka Qendrore e Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 32 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Autoritetin Rregullativ i Hekurudhave. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 24 e kanë nga një pozitë publike, 6 zyrtarë kanë nga dy pozita, 1 zyrtar ka tre pozita ndërsa 1 zyrtar ka 4 pozita.

Zyra Kombëtare e Auditimit

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 152 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Zyrën Kombëtare e Auditimit. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 150 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 7 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Zyrën e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Zyra e Rregullatorit për Energji

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 12 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Zyrën e Rregullatorit për Energji. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Radio Televizioni i Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 23 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Radio Televizionin e Kosovës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 19 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 4 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 8 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 7 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 1 zyrtar ka dy pozita.

Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 16 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 14 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Komisioni Rregullativ i Prokurorit Publik

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 9 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Komisionin Rregullativ i Prokurorit Publik. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 6 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 3 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 20 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 17 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 3 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 16 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 14 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Komisioni i Pavarur i Mediave

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 21 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Komisionin e Pavarur të Mediave. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 20 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 1 zyrtar ka tri pozita.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 8 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se këta zyrtarë kanë vetëm nga një pozitë publike.

Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 9 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Këshillin e Kosovës për Trashigimi Kulturore. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 8 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 1 zyrtar ka katër pozita.

Gjykata Kushtetuese

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 18 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Gjykatën Kushtetuese. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 16 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 2 zyrtarë kanë nga dy pozita.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

Nga të dhënat e Agjencisë Kundër Korrupsionit janë 8 zyrtarë që deklarojnë pasurinë të cilët mbajnë pozita në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Nga analiza e Organizatës Çohu është gjetur se nga këta zyrtarë, 4 e kanë nga një pozitë publike ndërsa 4 zyrtarë kanë nga dy pozita.

IV. Pushteti Ekzekutiv

GLPS ka analizuar deklaratimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë në AKK të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKM), të Ministrisë së Drejtësisë (MD), Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE), Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ).

KIPRED ka analizuar deklaratimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë në AKK nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Instituti GAP ka mbledhur dhe analizuar të dhënat nga deklaratimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë në AKK të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës.

Instituti “Columbus” ka analizuar të dhënat e angazhimeve publike të zyrtarëve të lartë të katër ministrive: Ministria e Bujqësisë dhe e Pylltarisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Forcës së Sigurisë.

Organizata INPO në këtë hulumtim ka analizuar të dhënat e deklaratimit të pasurisë së zyrtarëve publik në AKK të 38 komunat të Republikës së Kosovës, dhe të zyrtarëve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Në vazhdim janë paraqitur raportet e secilës organizatë për secilin institucion të veçantë, për të cilin është zhvilluar hulumtimi dhe analizimi i të dhënave nga deklaratimet e pasurisë të bëra nga zyrtarët publik në AKK.

1) Qeveria, Ministrinë dhe Agjencitë e ekzekutivit

Raportimi i GLPS:

Raporti lidhur me zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në:

1. Zyrën e Kryeministrit të Kosovës – ZKM;
2. Ministrinë e Drejtësisë – MD;
3. Ministrinë e Integritimit Evropian – MIE;
4. Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – MDIS;
5. Ministrinë e Punëve të Jashtme - MPJ.

Të gjeturat e hulumtimit bazuar në deklarin e të ardhurave pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit:

GLPS ka analizuar deklarinimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKM), të Ministrisë së Drejtësisë (MD), Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE), Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ).

Bazuar në hulumtimin tonë, nga këto 5 institucione, 429 zyrtarë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Nga këta zyrtarë, 52 prej tyre mbajnë më shumë se një pozitë, 33 prej tyre në institucione publike dhe 18 në institucione private.

Ndërsa, nga 429 zyrtarët të cilët e deklarojnë pasurinë e tyre, 17 prej tyre marrin me shumë se një pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës ndërsa 24 nga institucione private. Ndërsa nga 429 zyrtarë në total, 70 prej tyre marrin shtesa, mëditje dhe kompensime nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe 12 prej tyre marrin pension. 14 prej tyre nuk kanë deklaruar pagën që e marrin nga institucionet shtetërore dhe nga buxheti shtetëror ndërsa 14 prej tyre nuk kanë deklaruar asgjë pos emrit dhe pozitën në formularin e deklaratës. 1 nga 429 zyrtarë nuk ka deklaruar pagën e tij por vetëm mëditjen ndërsa, 7 prej tyre nuk e kanë deklaruar pagën e tyre nga institucioni publik por vetëm nga ai privat.

Rrjedhimisht, në **Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM)**, 120 zyrtarë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Nga gjithsej 120 deklarime, 33 zyrtarë mbajnë më shumë se 1 pozitë. 18 nga ta mbajnë më shumë se një pozitë në institucione publike ndërsa, 15 në institucione private. Ndërsa 13 prej zyrtarëve në këtë institucion kanë deklaruar se marrin mëditje dhe 4 nga këta zyrtarë kanë deklaruar se marrin pension nga Buxheti i Republikës së Kosovës. 2 nga këta zyrtarë nuk e kanë deklaruar vlerën e pagës së tyre nga buxheti shtetëror. Për më tepër, 5 nga ta nuk kanë deklaruar pagën që marrin nga institucioni publik por vetëm atë nga institucioni privat.

Nga **Ministria e Drejtësisë (MD)**, 53 zyrtarë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Nga gjithsej 51 zyrtarë, 12 prej tyre mbajnë më shumë se një pozitë, 8 nga ta mbajnë më shumë se një pozitë në institucione publike ndërsa, 3 nga ta në

institucione private. 10 prej këtyre zyrtarëve kanë deklaruar se marrin mëditje dhe 3 nga këta zyrtarë kanë deklaruar se marrin pension nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Nga **Ministria e Integritit Evropian (MIE)**, 22 zyrtarë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Bazuar në deklaratimet pranë kësaj agjencie, asnjëri nga këta zyrtarë nuk mbajnë pozitë të dytë. 12 prej këtyre zyrtarëve kanë deklaruar se marrin mëditje nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërsa, bazuar në deklaratimet e bëra në këtë agjenci, asnjë nga këta zyrtarë nuk marrin pension nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Nga **Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS)**, 27 zyrtarë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Bazuar në deklaratimet pranë kësaj agjencie, vetëm 1 zyrtar mban më shumë se një pozitë në një institucion publik. 13 prej këtyre zyrtarëve kanë deklaruar se marrin mëditje dhe 1 nga këta zyrtarë ka deklaruar se merr pension nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërsa, 3 nga këta zyrtarë nuk e kanë deklaruar vlerën e pagës së tyre nga buxheti shtetëror. Njëkohësisht, 1 nga zyrtarët nuk ka deklaruar pagën mirëpo vetëm mëditjen dhe 1 nga ta nuk ka deklaruar pagën që merr nga institucioni publik por vetëm ai privat.

Nga **Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)**, 207 zyrtarë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Nga 207 zyrtarë, 5 nga ta mbajnë më shumë se një pozitë në institucione publike. 20 prej këtyre zyrtarëve kanë deklaruar se marrin mëditje dhe 4 nga këta zyrtarë kanë deklaruar se marrin pension nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërsa, 8 nga këta zyrtarë nuk e kanë deklaruar vlerën e pagës së tyre nga buxheti shtetëror. Për më tepër, 1 nga ta nuk ka deklaruar pagën që merr nga institucioni publik por vetëm atë nga institucioni privat.

Të gjeturat e hulumtimit bazuar në të dhënat e ofruara nga ana e institucioneve përkatëse:

Pjesë e hulumtimit të zhvilluar ka qenë mbledhja e të dhënave lidhur me pagat, kompensimet dhe shtesat e secilit zyrtar nga secili institucion përkatës ku ata punojnë.

GLPS bazuar në Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumente publike në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), të Ministrinë e Drejtësisë (MD), Ministrinë për Integritim Evropian (MIE), Ministrinë për Diasporë dhe Investimeve Strategjike (MDIS) si dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ). Me anë të kësaj kërkesë, GLPS ka kërkuar nga secili institucion që të na ofrojë qasje në dokumentet si lista e pagave të zyrtarëve publik, lista e kompensimeve, mëditjeve, shtesave dhe çdo shpenzimi tjetër në kuptim të shpërblimit më pagesë të zyrtarit publik, nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 1 prill 2018 – 30 shtator 2018.

Nga këto 5 institucione, **Zyra e Kryeministrit të Kosovës (ZKM)** ka qenë institucioni më bashkëpunues në dërgimin e të dhënave të kërkuara ku me këtë rast ka dërguar të dhënat e zyrtarëve në Kabinetin e Ministrit, në Gazetën Zyrtare, në Zyrën e Kryeministrit, në Administratë, në Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, në

Zyrën për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë, në Zyrën për Komunitete, në Zyrën e Komisionit për Gjuhët, në Agjencionin për Barazi Ligjore, në Agjencionin për Mbrojtjen nga Rrezatimi Nuklear, në Agjencionin e Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës, si dhe të dhënat për personat që cilësohen si Simbol i Rezistencës dhe Qytetar me Merita të Veçanta. Ndërsa për Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore dhe Këshillin ndër ministror për ujëra (ish-task forca) nuk kemi pranuar asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e parashtruar.

Ndërsa, **Ministria e Drejtësisë (MD)** i është përgjigjur kërkesës sonë pjesërisht. I njëjti institucion nuk ka ofruar informata lidhur me të dhënat për shtesat, mëditjet dhe kompensimet që u shpërndahen zyrtarëve të kësaj ministrie.

Ministria e Integritit Evropian (MIE) i është përgjigjur kërkesës sonë duke ofruar listën e pagave dhe mëditjeve, shtesave dhe kompensimeve për zyrtarët e angazhuar në Zyrën e Ministrit dhe në Administratën Qendrore të ministrisë.

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS) ka dërguar të dhënat lidhur me pagat dhe shtesat e zyrtarëve në Kabinetin e Ministrit, Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm (Divizioni për Komunikim me Publikun, Divizioni për Prokurim Publik dhe Divizioni për Auditim të Brendshëm), Departamentin për Qendrat Kulturore në Diasporë (Divizioni për Themelimin dhe Mbikëqyrjen e Qendrave Kulturore në Diasporë, Divizioni për Hartimin dhe Përditësimin e Regjistrimit të Diasporës dhe Mërgatës), Departamentin për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë (Divizioni për Arsim Plotësues në Diasporë, Divizioni për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë), Departamentin për Hulumtime dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës (Divizioni për Koordinim dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës, Divizioni për Hulumtime dhe Analiza), Departamentin për Investime Strategjike (Divizioni për Promovimin e Investimeve Strategjike, Divizioni për Përgatitjen dhe Zbatimin e Projekteve për Investime Strategjike), Departamentin Ligjor (Divizioni për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, Departamenti për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit), Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme (Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa, Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime të Logjistikës).

Ndërkaq, **Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)** është renditur në institucionet më jobashkëpunuese ngaqë e njëjta nuk ka ofruar asnjë përgjigje për kërkesën tonë të përsëritur disa herë. Kështu e njëjta ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike dhe ka mohuar të drejtën qytetare për informimin publik të shpenzimit të parasë publike.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga ana e institucioneve, më poshtë janë të paraqitura të gjeturat e këtij hulumtimi.

Zyra e Kryeministrit të Kosovës (ZKM) ka gjithsej 388 zyrtarë ku 364 prej tyre marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Kabineti i Ministrit** ka gjithsej 86 zyrtarë ku 53 prej tyre marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Gazeta Zyrtare e**

Republikës së Kosovës ka gjithsej 2 zyrtarë dhe të dy marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Zyra e Kryeministrit** ka gjithsej 18 zyrtarë ku të gjithë marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Administra e ZKM-së** ka gjithsej 66 zyrtarë dhe të gjithë nga ata marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike** ka gjithsej 4 zyrtarë dhe asnjëri prej tyre nuk merr shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Zyra për Sfidat e Mijëvjeçarit në Kosovë** ka gjithsej 3 zyrtarë ku të tre marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Agjencioni për Barazi Gjinore** ka gjithsej 17 zyrtarë dhe të gjithë marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Zyra e Komisionit për Gjuhët** ka 7 zyrtarë në total dhe të shtatit marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Agjencioni për Mbrojtje nga Rrezatimi Nuklear** ka gjithsej 6 zyrtarë dhe të gjithë marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Zyra për Komunitete** ka 5 zyrtarë në total dhe 4 nga ta marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës** ka 170 zyrtarë në total dhe të gjithë marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërsa si **Simbol i Rezistencës dhe Qytetar me Merita të Veçanta**, ZKM numëron 4 persona.

Në **Ministrinë e Drejtësisë (MD)** janë të angazhuar gjithsej 1817 zyrtarë ku 23 prej tyre janë të angazhuar në **Kabinetin e Ministrit**, 14 prej tyre në **Zyrën e Sekretariatit**, 25 prej tyre në **Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme**, 19 prej tyre në **Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar**, 15 prej tyre në **Departamentin Ligjor**, 5 prej tyre në **Departamentin për Integrim Evropian**, 4 prej tyre në **Departamentin për Profesione të Lira**, 11 prej tyre në **Avokaturën Shtetërore**, 61 prej tyre në **Institutin e Mjekësisë Ligjore**, 7 prej tyre në **Institutin për Hulumtime dhe Krime të Luftës**, 75 prej tyre në **Shërbimin Sprovues të Kosovës**, 99 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Prizren**, 107 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Pejë**, 142 prej tyre në **Burgun e Sigurisë së Lartë**, 80 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë**, 140 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Lipjan**, 55 prej tyre në **Drejtorinë Qendrore**, 54 prej tyre në **QK Smrekonicë**, 87 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Gjinal**, 85 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Lipjan**, 85 prej tyre në **Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë**, 599 prej tyre në **Shërbimin Korrektues të Kosovës** dhe në 25 prej tyre në **Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar**. Nga të gjithë zyrtarët në këtë ministri, 22 prej tyre marrin shtesa dhe kompensime. Kështu, nga 107 zyrtarë në **Qendrën e Paraburgimit në Pejë**, 1 prej tyre merr kompensim. Nga 142 zyrtarë në **Burgun e Sigurisë së Lartë**, 1 prej tyre merr kompensim. Nga 80 zyrtarë në **Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë**, 1 prej tyre merr kompensim. Nga 55 zyrtarë në **Drejtorinë Qendrore**, 2 prej tyre marrin kompensime. Nga 85 zyrtarë në **Qendrën e Paraburgimit në Lipjan**, 1 prej tyre merr kompensim. Nga 85 zyrtarë në **Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë**, 1 prej tyre merr kompensim. Nga 599 zyrtarë në **Shërbimin Korrektues të Kosovës**, 11 prej tyre marrin kompensime. Nga 25 zyrtarë në **Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar**, 4 prej tyre marrin kompensime.

Në **Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE)** janë të angazhuar gjithsej 94 zyrtarë prej të cilëve 22 persona janë të angazhuar në **Zyrën e Ministrit** dhe 7 prej tyre marrin kompensime, 5 prej tyre marrin shtesa dhe 3 paguhen shtesë për punën e bërë. Nga 94 zyrtarët në total, 72

persona janë të angazhuar në Administratën Qendrore të ministrisë nga të cilët 67 nga ta marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Në **Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS)** ka gjithsej 78 zyrtarë ku 34 prej tyre marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Kabineti i Ministrit** ka gjithsej 27 zyrtarë ku 17 prej tyre marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm** ka gjithsej 51 zyrtarë të ndarë në Departamente dhe Divizione të veçanta ku 26 prej tyre në total marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Kështu, 2 zyrtarë nga **Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm**, 2 zyrtarë nga **Divizioni për Komunikim me Publikun**, 1 nga **Divizioni për Prokurim Publik**, 1 nga **Divizioni për Auditim të Brendshëm**, 1 nga **Departamenti për Qendrat Kulturore në Diasporë**, 0 nga **Divizioni për Themelimin dhe Mbikëqyrjen e Qendrave Kulturore në Diasporë**, 1 nga **Divizioni për Hartimin dhe Përditësimin e Regjistrimit të Diasporës dhe Mërgatës**, 1 nga **Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë**, 2 nga **Divizioni për Arsim Plotësues në Diasporë**, 3 nga **Divizioni për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë**, 0 nga **Departamenti për Hulumtime dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës**, 1 nga **Divizioni për Koordinim dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës**, 0 nga **Divizioni për Hulumtime dhe Analiza**, 1 nga **Departamenti për Investime Strategjike**, 1 nga **Divizioni për Promovimin e Investimeve Strategjike**, 0 nga **Divizioni për Përgatitjen dhe Zbatimin e Projekteve për Investime Strategjike**, 1 nga **Departamenti Ligjor**, 1 nga **Divizioni për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit**, 1 nga **Divizioni për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit**, 1 nga **Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme**, 1 nga **Divizioni për Burime Njerëzore**, 1 nga **Divizioni për Buxhet dhe Financa** dhe 2 nga **Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime të Logjistikës** marrin shtesa nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Raporti i KIPRED:

Për projektin e “Javës Kundër Korrupsion 2018,” Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), ka analizuar të dhënat e zyrtarëve të lartë të institucioneve qeveritare që kanë për obligim deklarimin e pagave, pozitave zyrtare dhe pasurinë e tyre, raportime këto që duhet t’i bëjnë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit. Analiza e këtyre të dhënave përfshin periudhën e vitit 2017. Po ashtu, KIPRED-i në këtë raport analizon edhe të dhënat e dërguara nga Ministrinë përkatëse, që janë dërguar nga këto Ministri pas kërkesës së KIPRED-it për qasje në dokumentet publike. Në të dhënat e dërguara nga Ministrinë përfshihen pagat, mëditjet, komisionet etj, dhe analiza përfshin periudhën prill – shtator 2018.

KIPRED-i ka analizuar deklaratimet e zyrtarëve të lartë për pesë Ministri:

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
- Ministria e Administratës Publike (MAP),

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH),
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS),
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social

Sipas të dhënave të raportuara në Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, figuron se deklarimin e pasurisë së tyre e kanë bërë 38 persona. Prej tyre 34 persona janë që mbajnë vetëm nga një pozitë në MPMS, me nga dy pozita janë 3 persona, dhe një person i ka 3 pozita. Pozitat e zyrtarëve që mbajnë më shumë se një pozitë në MPMS janë ato të Anëtarit të Këshillit, të Ligjëruesit në Odën Ekonomike, të trajnerit në IKAP (Instituti i Kosovës për Administratë Publike), etj.

Ndërkaq, sa i përket të hyrave të zyrtarëve në MPMS, janë 30 persona që kanë nga 1 të hyrë, me dy të hyra janë 4 persona dhe me tre të hyra janë 4 persona. Dy prej zyrtarëve kanë edhe pension nga TMK-ja.

Po ashtu, nga të dhënat prill – shtator 2018 të dërguara nga MPMS-ja, figuron që zyrtarët e lartë pagën e marrin vetëm si të hyrë, ndërkaq gati të gjithë zyrtarët marrin edhe mëditje nga MPMS-ja.

Ministria e Administratës Publike

Sipas të dhënave të raportuara në Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Administratës Publike, figuron që deklarimin e pasurisë së tyre e kanë bërë 32 persona. Prej tyre 25 mbajnë vetëm nga një pozitë në MAP, me nga dy pozita janë 5 veta, dhe me tre pozita është 1 person. Pozitat e zyrtarëve që mbajnë më shumë se një pozitë në janë ato të Anëtarëve të Këshillit, të Ligjëruesit në UP, të Këshilltarit të Kuvendeve Komunale, etj. Ndërkaq, sa i përket numrit të të hyrave të zyrtarëve në MPMS, 26 persona janë me nga një të hyrë, me dy të hyra janë 4 persona, dhe me tre të hyra janë 2 persona. Dy prej tyre marrin pagë nga MAP-i, dhe, po ashtu, edhe si Këshilltarë të Kuvendit Komunal, si dhe pension nga MPMS.

Po ashtu, nga të dhënat prill – shtator 2018 të dërguara nga MAP figuron që zyrtarët e lartë pos pagës marrin edhe një të hyrë të klasifikuar si shtesë. Pothuaj të gjithë zyrtarët marrin edhe mëditje nga MAP-i.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Sipas të dhënave të raportuara në Agjencinë Kundër Korrupsionit, nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor figuron që deklarimin e pasurisë e kanë bërë 48 persona. Prej tyre 42 mbajnë vetëm nga një pozitë në MMPH, me nga dy pozita janë 5 veta, dhe me tre pozita është 1 person. Pozitat e zyrtarëve që mbajnë më shumë se një pozitë në MMPH janë ato të Ligjëruesit në UP, të Këshilltarit të Kuvendeve Komunale, mjekut, etj.

Ndërkaq, sa i përket numrit të të hyrave të zyrtarëve në MMPH, 43 persona janë me nga një të hyrë, me nga dy të hyra janë 3 persona, dhe me nga tre të hyra i kemi 2 persona. Dy prej tyre kanë të hyra nga MASHT-i, Ministria e Shëndetësisë, Kuvendi Komunal, dhe QKUK-ja.

Nga të dhënat prill – shtator 2018 të dërguara nga MMPH-ja figuron që zyrtarët e lartë marrin pagën, dhe, po ashtu, gati të gjithë marrin edhe mëditje nga MMPH-ja për udhëtime zyrtare.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Sipas të dhënave të raportuara në Agjencisë Kundër Korrupsion nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, figuron që deklarinimin e pasurisë së tyre e kanë bërë 106 persona. Prej tyre 64 e mbajnë vetëm nga një pozitë në MKRS, me nga dy pozita janë 31 veta, me tre pozita janë 10 veta, ndërkaq, një person i ka katër pozita. Pozitat e zyrtarëve që kanë më shumë se nga një pozitë në MMPH janë ato të Ligjëruesit në UP, të Këshilltarit të Kuvendeve Komunale, të Anëtar të Këshillave Drejtuese, të arsimitarit në shkollat të mesme, si dhe shumë pozita me emërtime të tjera.

Një numër i zyrtarëve të lartë në MKRS si punë primare i kanë ato në institucionet e tjera publike. Ndërkaq, në MKRS janë Anëtarë të Këshillave Drejtuese si dhe në pozita të tjera, por që kanë të hyra nga MKRS-ja.

Ndërkaq, sa i përket numrit të të hyrave të zyrtarëve në MMPH, 41 persona janë me nga 1 të hyrë, me dy të hyra janë 36 persona, me nga tre të hyra janë 9 persona, ndërkaq, 2 persona kanë nga pesë të hyra. Disa prej këtyre zyrtarëve kanë të hyra nga MKRS-ja, MASHT-i, Kuvendi Komunal, MFSK-ja, UP-ja, Filharmonia, FSK-ja, etj.

Nga të dhënat prill – shtator 2018 të dërguara nga MKRS, figuron që zyrtarët e lartë marrin pagën dhe mëditjet, dhe, po ashtu, në të dhëna figurojnë edhe zyrtarët e lartë që punën primare e kanë në institucione tjera, ndërkaq në MKRS kanë të hyra vetëm si kompensim.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Sipas të dhënave të raportuara në Agjencinë Kundër Korrupsionit nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, figuron që në MASHT deklarinimin e pasurisë së tyre e kanë bërë 281 persona. Prej tyre 165 veta mbajnë vetëm nga një pozitë në MASHT, me nga dy pozita janë 98 persona, me tre pozita janë 17 persona, ndërkaq, një person është me katër pozita. Pozitat e zyrtarëve që mbajnë më shumë se një pozitë në MMPH janë ato të Ligjëruesit në dy Universitete publike, të arsimitarit në shkollën fillore dhe të mesme, të dekanit në universitetet publike, të këshilltarit në dy institucione të ndryshme, të anëtarit të këshillave drejtues në ministri të tjera, si dhe nga 2 apo më shumë pozita në institucionet e tjera si Kuvendi i Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Prokuroria, QKUK-ja, Instituti Historisë, ASHAK-ja, etj.

Sa i përket numrit të të hyrave të zyrtarëve në MASHT, 141 persona janë me nga 1 të hyrë, me nga dy të hyra i kemi 79 persona, me nga tre të hyra janë 43 persona, me nga katër të hyra kemi 8 persona, ndërkaq, 4 veta i kanë nga pesë të hyra.

Zyrtarët që kanë më shumë se një të hyrë ato i marrin nga institucionet tjera qeveritare si BQK-ja (Banka Qendrore e Kosovës), Ministria e Shëndetësisë, Kuvendi Komunal, Drejtoritë Komunale, MRKS-ja, Prokuroria dhe Gjykata.

Ndërkaq, nga të dhënat prill – shtator 2018, MASHT-i, nuk i ka dërguar të dhënat për zyrtarët e vet të lartë, meqë Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it nuk e ka aprovuar dërgimin e tyre, edhe pse ato ishin të përgatitura nga Departamenti i Financave, dhe të miratuara nga Departamenti Ligjor.

Instituti GAP:

Burimi i të ardhurave të zyrtarëve të lartë

Ky raport shpalos tendencën e punësimit në institucionet publike duke ngritur për diskutim çështjen e nivelit të cilësisë së kryerjes së punës nga zyrtarët e lartë të cilët kanë nga dy a po më shumë pozita pune dhe burime të të hyrave, qoftë si ligjërues, ekspertë të fushave të ndryshme, konsulentë, apo edhe pronarë e menaxherë të kompanive. Edhe pse disa fushëveprimtari janë të ligjshme sipas Ligjit nr. 06/1 -011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, cilësia e kryerjes së punëve vihet në dyshim atëherë kur me pozita të caktuara kërkohen përgjegjësi të mëdha dhe rezultatet janë të mangëta.⁶

I. Mbledhja e të dhënave të deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë në MF, MZHE, MTI dhe MI

Instituti GAP ka mbledhur dhe analizuar të dhënat nga deklaramimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Për të bërë krahasim e të dhënave, kemi dërguar edhe kërkesa në ministritë e lartpërmendura, por kemi pranuar përgjigje vetëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe Zhvillimit Ekonomik dhe atë vetëm me informatat për pagat e zyrtarëve të lartë brenda ministrisë, por jo edhe të

⁶ Shih disa dispozita të Ligjit nr. 06/1 -011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik:

Neni 10, paragrafi 2 “gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje të tjera.”

Neni 12, paragrafi 1, “zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.”

Neni 13, paragrafi 1, “zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”

Neni 13, paragrafi 2 “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike (...) Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblymi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”

ardhurat nga burimet e tjera qoftë nga institucionet publike apo entitete të ndryshme private dhe jo-qeveritare.

Prandaj, të dhënat e shqyrtuara në këtë seksion janë të bazuara në vetë deklarinimin e zyrtarëve, por nuk kemi informata për zyrtarë potencialë që mund të mos kenë deklaruar të gjitha burimet e të hyrave.

II. Numri i zyrtarëve me më shumë se një burim të të hyrave nga institucionet publike

Më poshtë kemi radhitur numrin e zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar dy apo më shumë burime të të hyrave nga institucionet publike qofshin ato departamente brenda ministrive të ndryshme, agjenci, universitete publike, apo oda ekonomike, pa përfshirë këtu të hyrat nga kompanitë private apo kolegjet private.

Nga gjithsej 120 deklarime të pasurisë të zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Financave (MF), 12 prej tyre kishin burime të të ardhurave nga një apo më shumë institucione publike.

Kurse, nga 32 deklarime të pasurisë të zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), dy kishin burime të të ardhurave nga një apo më shumë institucione publike dhe tre nuk kishin deklaruar pagë nga MZHE, por vetëm të hyrat nga institucionet tjera publike apo institucionet private.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), nga 42 deklarime të pasurisë të zyrtarëve të lartë, tetë zyrtarë të lartë kanë deklaruar të hyra nga dy apo më shumë institucione publike.

Ndërkaq nga 31 deklarime të pasurisë të zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Infrastrukturës (MI), gjashtë zyrtarë të lartë kanë deklaruar të hyra nga dy apo më shumë institucione publike dhe një zyrtar i lartë nuk ka deklaruar të hyra personale fare, as nga institucioni përmes të cilit e ka deklaruar pasurinë.

III. Pagat bazë, mëditjet dhe llojet e punëve dytësore më të shpeshta

Ka raste kur zyrtarët e lartë kanë marrë më tepër mëditje se sa rroga bazë për një muaj, por jo më shumë se rroga vjetore. Megjithatë, numri i saktë i zyrtarëve të lartë me këtë dukuri është vështirë i matshëm pasi që shumica kanë raportuar një shumë totale të të hyrave duke përfshirë pagën bazë dhe mëditjet nga pozita që kanë në ministrinë përkatëse.

Disa karakteristika që kemi hasur gjatë analizimit të të dhënave ka qenë se shumica e zyrtarëve të lartë që kanë së paku dy burime të të hyrave nga institucionet publike, dhe të hyra të tjera nga organizata jo-qeveritare, institucione ndërkombëtare dhe kompani private të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në pozitat e mëposhtme:

- Ligjërues në universitetet publike të Kosovës, sic janë Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”, Universitetin i Pejës “Haxhi Zeka”
- Ligjërues/Trajnerë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Akademinë e Drejtësisë (AD), apo Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP)

- Pjesëtarë të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK)
- Anëtarë të komisioneve të ndryshme brenda ministrisë ku punojnë apo ministrive tjera
- Ekspertë për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK)
- Ekspertë komunikacioni në raste të aksidenteve
- Ekspertë për organizata dhe institucione ndërkombëtare me filiale në Kosovë
- Menaxherë/Pronarë të kompanive private

Megjithëse ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nuk ndalon veprimtari të arsimit, shkencës, apo aktivitete humanitare, ky ligj cek ndalon ofrimin e shërbimeve si ekspertë apo konsulentë, kompenzimin me pagë apo mëditje si anëtarë të komisioneve apo bordeve të institucioneve publike - përveç mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit, si dhe ushtrimin e detyrave menaxheriale/udhëheqëse në kompani private edhe në rast kur kompania është në pronë të zyrtarit apo zyrtares së lartë.

Instituti “Columbus”:

Instituti “Columbus” ka analizuar të dhënat e angazhimeve publike të zyrtarëve të lartë të katër ministrive. Ministria e Bujqësisë dhe e Pylltarisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë të cilat kanë qenë objekt i studimit kanë një numër të madh të zyrtarëve që përfitojnë me shumë se dy pagesa mujore nga institucionet publike.

Angazhimi kryesor i zyrtarëve në këto ministri mbetet angazhimi në arsim në cilësi të profesorit apo mësimdhënësit por ka numër të madh edhe të këtyre zyrtarëve që pos si zyrtarë të lartë në institucionet shetëtorë, dhe pjesë e universiteteve publike ata angazhohen në shumë raste edhe si profesionistë për ekspertiza të ndryshme. Ka të tillë që në të njëjtën kohë mban pesë ose gjashtë detyra të ndryshme.

Një çështje tjetër që instituti “Columbus” e ka identifikuar është edhe numri i madh i zyrtarëve të lartë që përfitojnë pensione nga shteti. Ka të tillë që përveç tre ose katër detyrave që kryejnë në institucione publike përfitojnë pensionin e veteranit dhe pensionin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK).

Forma se si janë nxjerrë të dhënat

Instituti “Columbus” ka bërë kërkesë për qasje në dokumente publike në katër ministrinë që i ka analizuar. Përveç kësaj përmes kërkesës zyrtare qasje në pagesa u është kërkuar edhe agjencioneve që veprojnë në kuadër të ministrive por që kanë bugjet të pavarur nga to.

Pjesa më e madhe e institucioneve që u është kërkuar informata kanë kthyer përgjigje por të dhënat që kanë ofruar kanë qenë të mangëta.

Si institucione me problematike për nxjerrjen e të dhënave është Policia e Kosovës. Ndonëse disa ditë pas kërkesës kanë thënë se janë në proces të mbledhjes dhe selektimit të të dhënave, informatat çka i ka ofruar ky institucion kanë qenë informata shumë të cekta.

“Columbus” e ka ripërseritur për tre herë me radhë kërkesën për këto informata dhe të tri përgjigjet kanë qenë përgjigje me të dhëna si emrat e zyrtarëve të lartë publik në këtë institucion apo pozitat që i mbajnë si dhe koficientet e pagave por jo pagesat e tjera që marrin nga ky institucion.

Ministria e Shëndetësisë si një nga institucionet me më se shumti zyrtarë publik që janë të obliguar të deklarojnë të dhënat në Agjencinë Kundër Korrupsion (për shkak të spitaleve e agjencive që funksionojnë në kuadër të MSh-së), poashtu ka ofruar bashkëpunim mënjeherë pasi “Columbus” i ka adresuar kërkesë për të dhëna. Megjithatë të dhënat që i ka ofruar kjo ministri nuk janë përputhur fare me të dhënat që vetë zyrtarët publik i kanë deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsion. Kësisoj vetë zyrtarët publik kanë deklaruar shumë me shumë angazhime se sa MSh-ja i ka ofruar në të dhënat për “Columbus”. Nisur nga kjo janë verifikuar shpërputhjet dhe ka dalur që me të përafërta janë të dhënat që vetë zyrtarët i kanë deklaruar se sa institucioni.

Krahasimi i të dhënave

Me disa dallime siç është theksuar edhe me lartë një pjesë e madhe e zyrtarëve publik marrin nga 2-3 pagesa në muaj vetëm nga sektori publik. Ka të tillë që kanë disa angazhime edhe në sektorin privat.

Ministria e Shëndetësisë është njëri nga institucionet me numrin me të madh të zyrtarëve publik që janë të obliguar të bëjnë deklarinimin e pasurisë . Kjo për shkak të specifikave të sektorit të shëndetësisë. Përveç që janë të obliguar me ligj zyrtarët e MSh-së të deklarojnë pasurinë, obligohen edhe menaxhmentet e spitaleve, Bordi drejtues I Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, drejtoret e Klinikave. Në anën tjetër në kuadër të MSh-së funksionojnë edhe agjencione që në linjen buxhetore dhe vendimmarrëse janë të pavarura nga MSh-ja, siç janë Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM) si dhe Fondi për Sigurime Shëndetësore (FSSh).

Ministria e Punëve të Brendshme poashtu ka një numër të madh të zyrtarëve të lartë që mbajnë detyrime me shumë pozita publike. Në mesin e zyrtarëve përfshihen edhe zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës .

Ministria e Bujqësisë është institucioni i cili ka me se pak zyrtarë që mbajnë me shumë se një pozitë publike. Edhe zyrtarët që mbajnë me shumë se një pozitë kryesisht kanë pozitën e detyrës si profesionistë të angazhuar në fushën e arsimit dhe edukimit.

Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës ka dhjetra zyrtarë që përveç pagës përfitojnë pensione. Disa prej tyre nga dy pensione.

Llojet e pagesave:

Profesorë në Universitete Publike- Ministria e Bujqësisë dhe institucionet e tjera nën vartësi të saj ka pesë zyrtarë që përveç pagës bazë në Ministrinë e Bujqësisë marrin edhe paga nga universitetet publike.

Ministria e Shëndetësisë ka tridhjetë e një zyrtarë që përveç se në spitale ose MSh janë të angazhuar edhe si profesorë ose asistent kryesisht në Fakultetin e Mjekësisë.

Ministria e Punëve të Brendshme ka shtatëmbëdhjetë zyrtarë të lart publik që përveç në MPB janë të angazhuar edhe në pjesën edukativo-arsimore (kryesisht në Skademinë e Kosovës për iguri Publike)

Ministria e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës ka pesë zyrtarë të lartë publik që përveç pagës në MFSK paguhen edhe për pjesën edukativo- arsimore.

Pagesat e tjera

59 zyrtarë të **Ministritë se Bujqësisë** e deklarojnë pasurinë në Agjencionin Kundër Korrupsion, prej tyre 21 kanë me shumë se dy nga institucionet publike. Kryesisht këta zyrtarë janë pjesë e komisionëve, janë këshilltarë komunal, pjesë e bordeve (psh. në Agjencionin e për Veterin, ose anëtar I bordit “Hidroregjioni”, PTK etj).

209 zyrtarë të **Ministritë se Shëndetësisë** e deklarojnë pasurinë në Agjencionin Kundër Korrupsion. Prej 209 zyrtarëve , 80 zyrtarë marrin me shumë se një pagë. Pagesa e dytë fillon nga këshilltar komunal, anëtarë të komisionëve, anëtarë të Bordeve brenda MSh-së, pozita politke e pozita të profesionistëve shëndetësorë në të njejtën kohë, ekspertë të angazhuar në shërbim të sistemit të drejtësisë. Vlen të cekët se disa zyrtarë me angazhimin prej eksperti ka sipas të dhenave pagë shumë me të madhe se sa paga bazë.

Rreth 15 zyrtarë të MSh-së idenfikuar me mbi 5 pozita. Ka prej tyre që kanë gjashtë ose shtatë me se shumti s aka indentifikuar “Columbus”. Një çështje që ja vlen të përmendet është që shumica prej tyre kanë të deklaruar edhe vperimtari në sektorin privat dhe duke shtuar faktin angazhimin shumë të madh në bazë të pagesave atëherë vihet në pikëpyetje efektiviteti i tyre në punë.

Ministria e Punëve të Brendshme ka 132 zyrtarë që deklarojnë pasurinë në Agjencion Kundër Korrupsion ka 34 zyrtarë me me shumë së një pozitë. Zyrtarët janë pjesë e komisioneve, anëtarë të Bordeve etj. Vlen të cekët se një pjesë e zyrtarëve të lart ani pse nuk kanë punë të dytë marrin pagë në forme të pensioneve (mbi dhjetë zyrtarë të lart)

Ministria e Forcës dhe Sigurisë se Kosovës (MFSK) Ka 46 zyrtarë publik që deklarojnë pasurinë në Agjencionin Kundër Korrupsion. Nga 46 zyrtarë rreth 20 marrin pensione të TMK-së e disa nga këta 20 marrin përveç pagës edhe pesnsion të TMK-së por edhe atë të veteranit.

2) MAPL dhe Komunat

Gjetjet e hulumtimit për konfliktin e interesit për zyrtarët komunal të Republikës së Kosovës Iniciativa për Progres – INPO

Organizata INPO ka hulumtuar për të ardhurat e zyrtarëve publik të institucioneve lokale të qeverisjes së Republikës së Kosovës nëpërmjet dy mënyrave:

- (i) përmes deklarimeve të pasurive që zyrtarët publik i kanë bërë në Agjencinë Kundër Korrupsion (AKK), dhe
- (ii) përmes të dhënave që komunat e Republikës së Kosovës na i kanë dërguar për zyrtarët publik.

Për mbledhjen e këtyre të dhënave, Organizata INPO ka has në probleme të vazhdueshme gjatë analizës së tyre, duke filluar nga të dhënat e mangëta ose mos-dërgimi i dokumenteve të kërkuara nga komunat e Kosovës, e deri tek të dhënat e mangëta të cilat i kanë deklaruar zyrtarët komunal në AKK. Megjithatë, hulumtimi ka arritur të identifikoj raste të konfliktit të interesit në komunat e Kosovës, duke treguar që ky problem ekziston dhe nuk luftohet nga institucionet publike.

Organizata INPO në këtë hulumtim ka analizuar të dhënat e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publik në AKK të 38 komunat të Republikës së Kosovës, dhe të zyrtarëve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Gjithsej, janë analizuar deklaratimet e pasurës së 1,765 zyrtarëve publik.

Në lidhje me nenin 13 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Organizata INPO ka identifikuar 47 raste të shkeljes së këtij neni nga zyrtarët e lartë komunal. Në bazë të dhënave të marra nga ueb-faqja e AKK-së, kjo është lista e identifikimeve e ndarë në komuna dhe për MAPL-në:

- Në komunën e Dragashit është identifikuar një rast,
- Në komunën e Ferizajt janë identifikuar nëntë raste,
- Në komunën e Fushë Kosovës janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Gjakovës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Glllogocit është identifikuar një rast,
- Në komunën e Graçanicës janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Istogut janë identifikuar katër raste,
- Në komunën e Leposaviqit është identifikuar një rast,
- Në komunën e Malishevës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Mitrovicës së Jugut janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Mitrovicës së Veriut është identifikuar një rast,
- Në komunën e Pejës janë identifikuar pesë raste,
- Në komunën e Podujevës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Prishtinës janë identifikuar pesë raste,

- Në komunën e Prizrenit janë identifikuar tri raste,
- Në komunën e Rahovecit është identifikuar një rast,
- Në komunën e Shtimes është identifikuar një rast,
- Në komunën e Skënderajt janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Suharekës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Vitisë është identifikuar një rast,
- Në komunën e Zubin Potokut është identifikuar një rast,
- Në MAPL është identifikuar një rast.

Në lidhje me nenin 12 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Organizata INPO ka identifikuar 29 raste të shkeljes së këtij neni nga zyrtarët e lartë komunal. Në bazë të dhënave të marra nga ueb-faqja e AKK-së, kjo është lista e identifikimeve e ndarë në komuna dhe për MAPL-në:

- Në komunën e Dragashit janë identifikuar tri raste,
- Në komunën e Ferizajt janë identifikuar pesë raste,
- Në komunën e Fushë Kosovës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Gjakovës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Gjilanit është identifikuar një rast,
- Në komunën e Mamushës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Mitrovicës së Jugut është identifikuar një rast,
- Në komunën e Novobërdës është identifikuar një rast,
- Në komunën e Pejës janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Podujevës janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Prishtinës janë identifikuar katër raste,
- Në komunën e Prizrenit janë identifikuar dy raste,
- Në komunën e Rahovecit është identifikuar një rast,
- Në komunën e Shtimes është identifikuar një rast,
- Në komunën e Skënderajt është identifikuar një rast,
- Në komunën e Suharekës është identifikuar një rast,
- Në MAPL është identifikuar një rast.

Organizata INPO këtë hulumtim është munduar ta realizoj edhe përmes të dhënave të marra nga komunat e Kosovës, ku përmes të drejtës për qasje në dokumente publike, ka kërkuar nga 38 komunat e Republikës të dhëna gjashtë (6) mujore mbi pagat, mëditjet dhe kompenzimet e tjera shtesë të zyrtarëve të lartë publik. Nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, vetëm 28 nga to kanë kthyer përgjigje. Komunat të cilat nuk kanë ofruar qasje, edhe pas kërkesave për rishqyrtim të çështjes janë: Dragash, Klinë, Klllokot, Leposaviq, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Podujevë, Prizren, Zubin Potok. Nga 28 përgjigjet, nëntë nga to kanë ardhur pas kërkesës për rishqyrtim. Pra, vetëm 19 komuna të Republikës së Kosovës kanë kthyer përgjigje pas kërkesës së parë për qasje në dokumente publike. Sa i përket përgjigjeve të marra nga komunat, 16 nga 28 përgjigjet ju janë përmbajtur kërkesës së Organizatës INPO. Pasi që Organizata INPO nuk ka arritur të marrë përgjigje nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, për shkak të objektivitetit të hulumtimit, janë përdorur të dhënat e AKK-së.

Ndër problemet e tjera që Organizata INPO ka identifikuar gjatë këtij hulumtimi janë:

- Mungesa e pozitës së punës në deklarinimet e zyrtarëve publik, ku ata kanë deklaruar vetëm burimin e të dhënës (sh. Komuna, Kuvendi Komunal, etj.),
- Pasqyrimi joreal i të hyrave të anëtarëve të Kuvendeve Komunale, ku disa nga ta nuk kanë deklaruar në mënyrë të rregullte pagën e tyre, disa nuk e kanë përmendur të ardhurën si anëtarë të komiteteve komunale, dhe disa nuk e kanë deklaruar fare pagën por vetëm e kanë deklaruar pozitën e punës,
- Sistemi i deklarinimit të AKK-së nuk i identifikon në mënyrë automatike të dhënat e dala nga deklarimi i zyrtarëve publik, ku identifikohen raste që një zyrtar deklarimi i atribuohet vetëm njëherë nga pozitat, edhe pse në deklarim ai ka shkruar dy pozita (sh. rasti i deklarinimit të pagës së një zv. Ministri, i cili e ka të shkruar edhe pozitën e anëtarit të Kuvendit Komunal, por nuk pasqyron si zyrtar tek kategoria e komunës përkatëse),
- Vetëm 11 zyrtarë të lartë publik të komunës së Vushtrrisë kanë deklaruar të ardhurat e tyre në AKK, në mesin e tyre që nuk kanë deklaruar të ardhurat është edhe kryetari i komunës së Vushtrrisë,
- Sistemi i deklarinimit të AKK-së nuk i kategorizon në mënyrë të rregullte zyrtarët e lartë publik të komunave ku ka raste të caktuara që zyrtarët e një komune i gjen në kategorinë e një komune tjetër,
- Sistemi i deklarinimit të AKK-së nuk i ka të dhënat e përditësuara ku ende zyrtarët të lartë publikë kanë të deklaruar të dhëna të vjetra (shembull: kryetarit të komunës i del pozita e anëtarit të kuvendit komunal apo drejtorit, pozita të cilat i ka mbajtur më parë).

V. Pushteti gjyqësor dhe prokurorial

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka paraqitur kërkesa për qasje në dokumente publike lidhur me listat e pagave të zyrtarëve publik dhe të dhënat ku përfshiheshin pagat, kompensimet, medijtjet, shtesat dhe çdo shpenzim tjetër në kuptim të shpërblimit më pagesë të zyrtarëve të lartë publikë në sistemin gjyqësor, prokurorial dhe Akademinë e Drejtësisë.

Përderisa Akademia e Drejtësisë ka ofruar qasje në informatat e kërkuara, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, në kundërshtim me ligjin kanë refuzuar për të ofruar të dhënat e kërkuara edhe përkundër obligimit ligjor të përcaktuar sipas ligjit të aplikueshëm dhe shkresës së Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në mungesë të të dhënave dhe informatave të ofruara nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial lidhur me pagat, kompensimet, medijtjet, shtesat dhe çdo shpenzim tjetër në kuptim të shpërblimit më pagesë të zyrtarëve të lartë publikë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, IKD ka qenë i obliguar që analizën dhe hulumtimin ta bazojë përmes analizimit dhe nxjerrjes së informatave prej formularëve të deklarimit të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion për çdo zyrtar të lartë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Në këtë drejtim IKD ka analizuar formularët e deklarimit të pasurisë së 631 zyrtarëve të lartë publik në sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe Akademinë e Drejtësisë, nga të cilët 420 në sistemin gjyqësor, 203 në sistemin prokurorial dhe 18 në Akademinë e Drejtësisë.

Nga 631 zyrtarë të lartë publikë që ushtrojnë funksione publike në sistemin gjyqësor, prokurorial dhe akademinë e drejtësisë, ku pëfshihen anëtarë të Këshillit Gjyqësor, anëtar të Këshillit Prokurorial, gjykatës, prokuror dhe shërbyes civil, IKD ka identifikuar numër të madh të tyre që në të njëjtën kohë ushtrojnë më shumë se dy pozita në sektorin publik.

Nga 631 zyrtarë të lartë publik, IKD ka identifikuar një prokuror dhe një gjykatës që ushtrojnë në të njëjtën kohë pesë funksione, një prokuror dhe tre gjykatës që ushtrojnë katër funksione, 13 zyrtarë të sistemit prokurorial dhe 11 zyrtarë të sistemit gjyqësor që ushtrojnë tre funksione, dhe 38 zyrtarë në sistemin prokurorial dhe 23 zyrtarë në sistemin gjyqësor që ushtrojnë nga dy pozita.

Nga 420 zyrtarët e lartë publik në sistemin gjyqësor të Kosovës, 38 prej tyre ushtrojnë së paku dy funksione në të njëjtën kohë. Nga 203 zyrtarë të lartë publik në sistemin prokurorial të Kosovës, 53 prej tyre ushtrojnë së paku dy funksione publike në të njëjtën kohë. Ndërsa në Akademinë e Drejtësisë nuk janë identifikuar zyrtarë të lartë publik që ushtrojnë dy funksione në të njëjtën kohë.

IKD gjatë analizimit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik në sistemin gjyqësor dhe prokurorial ka gjetur se numër i madh i zyrtarëve të lartë, gjatë deklarimit të pasurisë me qëllim kanë bërë maskimin e të ardhurave financiare që marrin qoftë përmes pagës së dytë apo kompenzimeve tjera materiale që paguhet nga buxheti i shtetit për shkak të ushtrimit të

funksiioneve tjera apo pjesëmarrjës së tyre në borde të ndryshme, grupe punuese apo komisione.

IKD në shumë raste ka identifikuar kur zyrtarët e lartë publikë në të njejten kolonë të deklarimit të pasurisë, kanë përfshirë përveç pagës bazë edhe pagat apo kompenzimet që marrin në institucione tjera publike.

Një qasje e tillë e zyrtarëve të lartë publik, mund të ndërlidhet edhe me kufizimin që Ligji për Gjykatat dhe Ligji për Prokurorin e Shtetit përcaktojnë që gjykatësit dhe prokuroret që ushtrojnë veprimtari profesionale përveç pozitës së gjykatësit dhe prokurorit, iu ndalohet të pranojnë shpërblim apo kompenzim që tejkalonë vlerën prej njëzet e pesë përqind (25%) të pagës bazë.

IKD gjatë analizimi të të hyrave të zyrtarëve të lartë publik ka identifikuar në shumë raste kur zyrtarët publik, pranojnë kompenzime dhe të hyra shtesë përveç nga buxheti i Kosovës edhe nga donator të jashtëm, e në raste të rralla përfshirë edhe të hyra apo kompenzime nga organizata jo-qeveritare.

Karakteristikë e të gjeturave paraqet fakti se jo rrallë herë zyrtarët e lartë publik pranojnë kompensime shtesë në të ardhura që janë pothuajse të barazvlefshme me pagën primare.